



Republic of Kosovo
Ministry of Foreign Affairs
Diplomatic Academy



Ambassade de France au Kosovo

PROTOKOLI i MARRËVESHJES

për

Orët e subvencionuara nga Ambasada e Francës në Kosovë për semestrin e parë 2015

për diplomatët e regjistruar në Akademinë Diplomatike.

Në mes:

Ambasadës së Francës në Kosovë, rruga Ismail Qemali nr 67, 10000 Prishtinë, Kosovë, e përfaqësuar nga Zonja Maryse DAVIET, tutje referuar ambasada

dhe

Akademisë diplomatike, rruga Luan Haradinaj Prishtinë, në Kosovë, e përfaqësuar nga drejtori i saj, Z. Ambasador Skender DURMISHI, tutje referuar Akademia Diplomatike

Është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1: Ambasada e Francës organizon një sesion të kurseve për semestrin e parë të vitit 2015.

Neni 2: Ky sesion përfshin kurse të frëngjishtes të niveleve A1. dhe A1.2 të Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët, për dy grupe nga 7 dhe 8 pjesëmarrës secili.

Neni 3: Grupet e pjesëmarrëve formohen nga propozimi i Akademisë diplomatike.

Neni 4: Sesioni është plotësisht i financuar nga Ambasada. Ai nënkupton një kurs javor prej 1orë e 30 min, për grupin e nivelit A1(grupi 1) , dhe 2 kurse javore prej 1orë e 30 min per grupin A1.2 (grupi 2). Kurset do të zgjasin 15 javë , nga 9 shkurt 2015 gjer më 1 qershor , ose në përgjithësi 22 orë e gjysmë për grupin 1 dhe 45 orë mesimi për grupin 2.

Neni 5: Këto kurse do të mbahen në Akademinë diplomatike, në lokalet e ministrisë së punëve të jashtme, në rrugën Luan Haradinaj, në Prishtinë.

Neni 6: Kursi do të mbahet nga një mësimdhënës gjuha amtare e të cilit është frëngjishtja.

Neni 7: Materiali pedagogjik do të ofrohet nga Ambasada e Francës në Kosovë.

Neni 8: Për 8 pjesëmarrësit në kurs të grupit A1.2, ambasada e Francës financon abonimin vjetor në mediatekën e Aleancës Franceze në Prishtinë.

Neni 9: Akademia diplomatike angazhohet të sigurojë një klasë të pajisur me një CD player dhe një tabelë të bardhë.

Neni 10: Pjesëmarrësit e regjistruar angazhohen, nën mbikëqyrjen e Akademisë diplomatike të jenë të pranishëm të paktën 8 orë të mësimit gjatë tërë sesionit.

Neni 11: Në rast të mungesës së pamotivuar të një pjesëmarrësi në më shumë se 6 orë të mësimit, Ambasada e Francës rezervon të drejtën e anulimit të regjistrimit të tij.

Neni 12: Një certifikatë e kurseve të përfunduara do t'i lëshohet çdo pjesëmarrësi në fund të sesionit të kursit.

Neni 13: Ambasada e Francës merr përsipër tarifën e regjistrimit në provimin DELF A1 për 8 pjesëmarrësit e grupit A1.2.

Neni 14: Ky Protokol do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit dhe do të përfundojë më 1 qershor 2015.

Neni 15: Ky protokol nënshkruhet në katër kopje origjinale, dy në gjuhë frënge dhe dy në gjuhën shqipe.

Prishtinë, më 2 shkurt 2015

Për Ambasadën e Francës në Prishtinë



Maryse DAVIET

Për Akademinë diplomatike



Skender DURMISHI